



Pranuar / Dorezuar Primijsno / Predato Received / Delivered	23-01	2023	3	viti god year
Organ / Njësia Org. / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSHICK	688/2023		112	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.69/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Malsore Gashi, me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, duke vepruar sipas ankesës më numër A.nr.69/2023 të datës 16.01.2023 të parashtruar nga ankuesja në çështjen juridike "Transferim ne rast të riskstrukturimit", bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe neni 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 23.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar me ankesën A.nr.69/2023 të datës 16.01.2023, të parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës, më datë 16.01.2023, ka parashtruar ankesë me numër protokollit 347/2023, e regjistruar nën shenjën A.nr. 69/2023 kundër Aktit të Emërimit AE.Nr.58/2022 të datës 13.12.2022 si dhe Njoftimit të datës 27.12.2022 të Menaxheres së Divizionit të Burimeve Njerëzore të Administratës Tatimore të Kosovës.

Ankuesja po në të njëjtë datë gjegjësisht me datë 16.01.2023 ka parashtruar edhe kërkesën për tërheqjen e ankesës së regjistruar me numër protokollit 347/2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në nenin 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë", ka konstatuar se janë kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të filluar me ankesën A.nr.69/2022 të datës 16.01.2023, pasi që ankuesja Ardiana Latifi përmes kërkesës së datë 16.01.2023 ka tërhequr ankesën e parashtruar me datë 16.01.2023.

Theksuar si me sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.69/2023

Ilire Mehmeti-Shaqiri


Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Udhëheqëses së BNJ të ATK-së; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

